



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2735

NR. VENDIMI 2189



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Nr.2735 Regj Them
Dt.26.07.2019

Nr.2189 Vendimi
Dt.01.10.2019

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS“

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga,

GJYQTAR

GERD HOXHA

asistuar prej sekretares gjyqësore **Znj.Silvi Xhakolli**, sot më datë **01 tetor 2019**, me pjesëmarrjen e **Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, përfaqësuar nga prokurori **Z. *****, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale nr.2735 akti, në ngarkim të :
Të pandehurit : *******, i biri i ***** dhe i *****, i dtl. *******, lindur në ***** dhe banues në *****, shqiptar, i martuar, arsimit të lartë, i padënuar, identifikuar me letërnjoftim Nr.personal *******, i mbrojtur nga Av. *******.

Akuzuar : Për veprat penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, parashikuar nga neni 149/a të Kodit Penal.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi shqyrtoi provat shkresore, dëgjoi prokurorin, i cili kërkoi :

Deklarimin fajtor të pandehurit ******* për kryerjen e veprës penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal dhe dënimin e tij me ******* muaj burgim.

Në aplikim të nenit 63 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim duke u urdhëruar i pandehuri të kryej një punë në interes publik prej ******* orësh për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh.

Pagimin e shpenzimeve procedurale në ngarkim të të pandehurit.

dëgjoi mbrojtësin dhe të pandehurin që, e pranoi akuzën dhe kërkoi një dënim sa më të butë, me atë të kërkuar nga organi akuzës; si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi;

V E R E N

Se, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është sjellë për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurit ***, akuzuar për kryerjen e veprën penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, parashikuar nga neni 149/a të Kodit Penal.

Në seancë paraprake, mbrojtja dhe i pandehuri ***, bazuar në nenin 403 të K.Pr.Penale bënë kërkesë për gjykim të shkurtuar, e cila nuk u kundërshtua nga organi i akuzës. Këtë kërkesë, mbrojtësi e përsëriti edhe gjatë gjykimit të themelit. Gjykata pasi studioi aktet e paraqitura nga Prokuroria në fashikullin e gjykimit, bazuar në nenin 405 të K.Pr.Penale çmoi se, kërkesa duhet pranuar pasi, çështja mund të zgjidhet në gjendjen, në të cilën ndodhen aktet.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se, me date 11.12.2018, seksioni për krimin ekonomik dhe financiar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë në bashkëpunim me inspektorët e hetimit tatimor kanë kryer kontroll pranë dyqanit të shtetasit ***, i ndodhur në rrugën e “****rës”. Nga kontrolli ka rezultuar se në këtë ambient të marrë me qera nga shtetasi *** ndodheshin disa artikuj si çanta dhe portofola të markave të njohura.

Nga verifikimi i ushtruar është evidentuar fakti se subjekti *** është *** me nipt *** dhe në dyqanin që ushtron aktivitet tregëtar janë konstatuar *** copë çanta të markave ***, *** tre copë dhe *** një copë. Nga personat që kanë ushtruar komntroll të pandehurit i është kërkuar të paraqesë licencën për tregtimin e këtyre artikujve siç parashikon ligji për markat e mbrojtura, por ai ka vendosur në dispozicion disa fatura tatimore, ku vërtetohej se këto mallra i kishte blerë prane disa subjekteve të tjera. Pra artikujt që i janë gjetur të pandehurit nuk kanë qenë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës ligjor, për mbrojtjen e markave, me pëlqimin ose autorizimin e pronarit të këtyre markave.

Nga ana e inspektoreve te hetimit tatimor është realizuar një verifikim i plotë i të gjithë mallit që ndodhej në dyqanin e shtetasit *** dhe ka rezultuar se ka nuk ka disponuar dokumentacionin ligjor për mbrojtjen e markave.

Në këto kushte, në analizë të fakteve dhe provave vërtetohet se i pandehuri *** ka kryer veprën penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal.

Në këto rrethana, prokurori pretendon se, i pandehuri ka konsumuar plotësisht elementët e veprës penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, parashikuar nga neni 149/a të KP.

Gjatë gjykimit, i pandehuri mbajti qëndrim pendues dhe pohues sa i përket faktit penal. Ai pretendoi se, veprat i ka kryer nga padjenia për ligjin penal. Për pasojë, ai kërkoi një dënim sa më të butë pasi, është kryefamiljar, i padënuar dhe ka qenë që në fillim bashkëpunues me organet e ndjekjes penale

Faktet e parashtruara më sipër provohen përveç sa më sipër edhe nga tërësia e akteve e ndodhura në fashikullin e procedimit penal nr. ***, viti ***, fashikulli i gjykimit në seancë paraprake nr. *** si dhe pohimi i të pandehurit si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe gjatë gjykimit.

Sa i përket kualifikimit ligjor të veprimeve të kryera më sipër nga i pandehuri

Gjykata vëren se, do t'u referohet këtyre dispozitave ligjore :

Nenit 149/a të K.Penal (ndryshuar me ligjin nr.23/2012), i cili parashikon se : « Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregëtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i : a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës ; b) produktit që mbrohet nga një dizenjo industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjnaso industriale ; c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare ; ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik ; të kryera me dashje, përbnëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit. »

Nga interpretimi dispozitës të mësipërme arrihet në përfundimin se, në nenin 149/a të KP ligjvënës ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike për garantimin e të drejtave të pronësisë industriale. Veprimet e shtetasve në kundërshtim me këto rregulla janë objekti i këtyre veprave penale dhe passjellin përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që :

nga ana objektive kjo vepër kryhet me anë të prodhimit, shpërndarjes, mbajtjes për qëllime tregëtimi, shitjes, ofrimit për shitje, furnizimit, shpërndares, eksportimit ose importimit për qëllime të parashikuara nga gërmat a) – ç) të nenit 149/a të KP;

subjekti i kësaj vepre penale duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale (16 vjeç) dhe të jetë i përgjegjshëm;

nga ana subjektive, kjo vepër penale kryhen me dashje. Qëllimi parashikuar në dispozitë është element cilësues i veprës penale.

Në rastin konkret, siç rezultoi nga shqyrtimi gjyqësor i akteve të sjella nga prokurori në fashikullin për gjykim, i pandehuri i ka konsumuar të dyja veprën penale për të cilat akuzohet. Konkretisht, nga provat e administruara në fashikullin për gjykim rezultoi se, me date 11.12.2018, seksioni për krimin ekonomik dhe financiar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë në bashkëpunim me inspektorët e hetimit tatimor kanë kryer kontroll pranë dyqanit të shtetasit ***, i ndodhur në ***. Nga kontrolli ka rezultuar se në këtë ambient të marrë me qera nga shtetasi *** ndodheshin disa artikuj si çanta dhe portofola të markave të njohura.

Nga verifikimi i ushtruar është evidentuar fakti se subjekti *** është *** me nipt *** dhe në dyqanin që ushtron aktivitet tregëtar janë konstatuar *** copë çanta të markave ***, *** tre copë dhe *** një copë. Nga personat që kanë ushtruar komntroll të pandehurit i është kërkuar të paraqesë licencën për tregtimin e këtyre artikujve siç parashikon ligji për markat e mbrojtura, por ai ka vendosur në dispozicion disa fatura tatimore, ku vërtetohej se këto mallra i kishte blerë prane disa subjekteve të tjera. Pra artikujt që i janë gjetur të pandehurit nuk kanë qenë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës ligjor, për mbrojtjen e markave, me pëlqimin ose autorizimin e pronarit të këtyre markave.

Nga ana e inspektoreve te hetimit tatimor është realizuar një verifikim i plotë i të gjithë mallit që ndodhej në dyqanin e shtetasit ***, dhe ka rezultuar se ka nuk ka disponuar dokumentacionin ligjor për mbrojtjen e markave.

Në këto kushte, në analizë të fakteve dhe provave vërtetohet se i pandehuri *** ka kryer veprën penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar

nga neni 149/a i Kodit Penal.

Në këto rrethana, prokurori pretendon se, i pandehuri ka konsumuar plotësisht elementët e veprës penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, parashikuar nga neni 149/a të KP.

Gjatë gjyqimit, i pandehuri mbajti qëndrim pendues dhe pohues sa i përket faktit penal. Ai pretendoi se, veprat i ka kryer nga padjenia për ligjin penal. Për pasojë, ai kërkoi një dënim sa më të butë pasi, është kryefamiljar, i padënuar dhe ka qenë që në fillim bashkëpunues me organet e ndjekjes penale

Bazuar në faktet e vërtetuara më sipër Gjykata arrin në përfundimin se, i pandehuri *** ka konsumuar plotësisht elementët e veprës penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” parashikuar nga neni 149/a të KP për shkak se.

Nisur nga sa më sipër Gjykata çmon se, i pandehuri duhet të deklarohet fajtor për këto dy vepra penale.

Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit Gjykata çmon se, duhen mbajtur parasysh këto rrethana :

Rrezikshmërinë relativisht të ulët të veprës penale të parashikuar nga neni 149/a i KP, për të cilën ligjvënësi ka parashikuar një dënim gjer në një vit burgim, duke e konsideruar si kundërvajtje dhe jo krim.

Faktin se, i pandehuri është treguar bashkëpunues me organet e ndjekjes penale që në momentin e parë. Faktin se, sasia e mallrave të kapura është e vogël.

Faktin se, i pandehuri është kryefamiljar, me arsim të lartë dhe ka persona në ngarkim. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore rezulton se, i pandehuri *** është i padënuar më parë.

Në këto kushte Gjykata, në vështrim të neneve 47-50 të K.Penal çmon se, rrethanat e mësipërme në të cilat është kryer vepra penale, në kompleksitet, nuk janë lehtësuese për të pandehurin *** dhe nuk justifikojnë izolimin e tij nga shoqëria por, një masë dënimi alternativ. Për pasojë Gjykata çmon se, i pandehuri *** duhet të dënohet me *** muaj burgim për kryerjen e veprës penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, parashikuar nga neni 149/a i KP.

Duke qenë se, i pandehuri u procedua gjykim të shkurtuar, bazuar në nenin 406 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri *** dënohet me *** ditë burgim. Në aplikim të nenit 63 të K.Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin e të pandehurit *** të përmbushë një punë në interes publik për një kohë prej *** orësh. Kjo punë duhet të përfundojë brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh. Gjatë kësaj periudhe i pandehuri do të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.

Duke qenë se, i pandehuri ***u deklarua fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale, i pandehuri detyrohet të paguajë shpenzimet proceduriale në fazën e hetimeve paraprake, si dhe shpenzimet gjyqësore.

Në përfundim të këtij arsytimi Gjykata çmon se, ky dënim do të shërbejë edukimit të të pandehurit, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, rehabilitimit të tij, si dhe parandalimit të përgjithëshëm të këtyre veprave penale në shoqëri.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 375, 379, 390, 406 e 485 të K.Pr.Penale,

V E N D O S I

Deklarimin fajtor të të pandehurit * për kryerjen e veprës penale të “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale“, e parashikuar nga neni 149/a i K.Penal dhe në bazë të këtij neni, dënimin e të pandehuri me *** muaj burgim.**

Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri * dënohet me *** ditë burgim**

Në aplikim të nenit 63 të K.Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin e të pandehurit * të përmbushë një punë në interes publik për një kohë prej *** orësh. Kjo punë duhet të përfundojë brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh. Gjatë kësaj periudhe i pandehuri do të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.**

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

U shpall në Tiranë, sot më dt. 01 tetor 2019!

SEKRETARE

GJYQTAR

SILVI XHAKOLLI

GERD HOXHA